



Data: 18.05.2018

Ref.: 487/HSD

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë: 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 55-të, të mbajtur më 10 Maj 2018, mori:

V E N D I M

- I. Nuk akreditohet programi i studimit i BPrAL Kolegji “Heimereri” (Gjakovë)
 - Infermieri, BSc, 180 ECTS.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji “Heimereri” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programit të studimit: Infermieri, BSc. 180 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Infermieri	BSc	180	Afërdita Mustafa, Rukije Pllana, Shukrije Baruti

AKA ka organizuar vizitë në Kolegjin “Heimereri” më 20.09.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekur me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Danica Zeleznik dhe Tatjana Gec.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 10 Maj 2018 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegji “Heimereri”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve Kolegji Heimerer nuk e ka te organizuar ne forme te mirefillte degen ne Gjakove. Aty mungone secili element i nje institucioni te arsimit te larte.

Sa i perket paisjeve ekspertet nenvizojne se aty ka vetem dy klasa dhe dy kompjuter. Ka mungese te madhe te infrastruktures te cilat jane te supozuar per mbulueshmerine e oreve teorike e te cilat jane: hapesirat, biblioteka etj. Kjo vjen ne shprehje sidomos kur kemi parasysh numrin e studenteve me te cilet ky institucion deshiron te startoj kete program.

Sa i perket stafit, ne degen ne Gjakovë jane te supozuara te ligjerojne disa infermiere por te cilat gjithashtu ligjerojne ne Prishtine dhe gjithashtu punojne ne klinike.

Eksperet nenvizojne se Kolegji Heimerer duhet te vazhdoj te zhvillohet edhe per nje kohe perpara se te filloj me degën ne Gjakovë.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji "Heimerer";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

